



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Parqeve
Periudha raportuese	Prill, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Parqeve përgjatë muajit prill, ka vazhduar realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës për trajtimin e hapësirave të gjelbra në komunën e Prishtinës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura", mbjellja e drurëve të rinj, krasitja e drurëve, prerja e drurëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Mirëmbajtja e varrezave të qytetit;
- Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në secilën zonë të kryeqytetit;
 - Mbrojtja dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbra brenda territorit të komunës së Prishtinës;
 - Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë;
 - Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme, në bashkëpunim me sektorë të tjerë përgjegjës;
 - Organizimi dhe koordinimi i planeve operationale të gjelbërimit;
 - Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete kulturore (jo afariste);
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative "Gërmia" për aktivitete kulturore dhe rekreative;

- *Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Tokës, më 22 prill, përmes kampanjës "Bëhu mik i Tokës";*
- *Kontakti me seli diplomatike, biznese dhe institucione të tjera për sigurimin e donacioneve të drurëve të rinj;*
- *Pranimi i informatave nga qytetarët, respektivisht nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;*
- *Identifikimi i këndeve të dëmtuara të lodrave;*
- *Përpilimi i projektit të mirëmbajtjes së këndeve të lodrave;*
- *Nisja e procedurave për hartimin e Planit të menaxhimit për peizazhin e mbrojtur "Gërmia";*
- *Finalizimi dhe dërgimi për prokurim i projektit të renovimit të hapësirës së kompleksit "Qafa".*

3. **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA** - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- *Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana e NPK "Hortikultura", krasitja e drurëve, prerja e drurëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre; (kryerja e pagesave në vlerë prej 177,182.00 euro për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra);*
- *Mirëmbajtja e varrezave të qytetit;*
- *Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në secilën zonë të kryeqytetit; (Drejtoria e Parqeve ka identifikuar mbi 30 hapësira publike në komunën e Prishtinës, të cilat mund të rigjenerohen përmes trajtimit gradual të tyre);*
- *Mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë;*
- *Identifikimi i këndeve të dëmtuara të lodrave; (Drejtoria e Parqeve ka finalizuar databazën me 25 kënde publike të lodrave, për të proceduar me kontratën e mirëmbajtjes së tyre);*
- *Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit;*
- *Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete kulturore (jo afariste);*
- *Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative "Gërmia" për aktivitete kulturore dhe rekreative;*
- *Rehabilitimi i ishujve mes korsive në rrugët "Dëshmorët e Kombit", "Rruga B" dhe Sheshi "Xhorxh Bush";*
- *Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Tokës, më 22 prill, përmes kampanjës "Bëhu mik i Tokës" (Drejtoria e Parqeve ka shënuar Ditën e Tokës me aktivitete të shumta, të shtrira në pesë zona të qytetit përgjatë ditës);*

- *Kontakti me seli diplomatike, biznese dhe institucione të tjera për sigurimin e donacioneve të drurëve të rinj; (Drejtoria e Parqeve ka kontaktuar seli diplomatike dhe biznese për kampanjën, me ç'rast janë grumbulluar më shumë se 1200 pemë të reja dhe janë shënuar dy aktivitete me Ambasadën Finlandeze dhe atë Sllovene);*
- *Nisja e procedurave për hartimin e Planit të menaxhimit për peizazhin e mbrojtur "Gërmia"; (Drejtoria e Parqeve ka përfunduar kërkesën për mbështetje teknike në hartimin e PM për peizazhin "Gërmia" dhe si rrjedhojë, në javët në vazhdim pret takimet e sërishme të grupeve punuese të procesit);*
- *Finalizimi dhe dërgimi për prokurim i projektit të renovimit të hapësirës së kompleksit "Qafa"; (Projekti ideor është finalizuar proceduar për procedim në prokurim në bashkëpunim me DIKMK;*

4. **AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR** - *Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:*

- *Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura";*
- *Mirëmbajtja e varrezave të qytetit;*
- *Krijimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë;*
- *Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme, në bashkëpunim me sektorë të tjerë përgjegjës;*
- *Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;*
- *Definimi i rrjetit të shtigjeve brenda peizazhit të mbrojtur "Gërmia".*

4.1.2 *Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.*

Për periudhën raportuese janë proceduar për pagesë: 95,192.64 euro.

4.1.3 **Takimet me palë**

Takimet me palë janë pjesë e procesit të punëve të përditshme, të cilat realizohen në bazë të shqyrtimit të kërkesave, që kanë të bëjnë me çështje të hapësirave të gjelbra dhe rigjenerimin e tyre sipas nevoja brenda komunës.

5. *Takimet me institucione të tjera*

Takim me Kabinetin e Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

Takim me OJQ "D4D", për projektin e realizimit të Parkut të të rinjve.

6. Diskutime publike / takime me qytetarë

Gjatë periudhës raportuese nuk është zhvilluar ndonjë diskutim publik, mirëpo janë takuar në vazhdimësi qytetarë për çështje të ndërlidhura me hapësirat e gjelbra të qytetit.

6.2. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

6.3.-Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

Numri i lëndëve të pranuar - 3;

Numri i lëndëve të kryera - 1;

Numri i lëndëve në proces - 2.

7. Takime të tjera

Takime me TEB, Korporatën "Rugova",

8. SFIDAT - Nëse gjatë zbatimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Gjatë realizimit të projekteve për këtë periudhë nuk kemi pasur pengesa për realizimin e projekteve.

9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

Mundësia e plotësimit të stafit të punëtorëve të dikasterit të Parqeve përmes procedurave të rekrutimit.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- *Përcjellja - mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPK "Hortikultura";*
- *Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit;*
- *Mirëmbajtja e varrezave të qytetit;*
- *Finalizimi i projekteve ideore për hapësira të reja rekreative sipas planit të veprimit;*
- *Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, më 5 qershor;*
- *Fillimi i zbatimit të projektit të mirëmbajtjes së këndeve të lodrave;*
- *Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative "Gërmia" për aktivitete kulturore dhe rekreative;*
- *Nisja e punëve të grupeve punuese për hartimin e Planit të menaxhimit për peizazhin e mbrojtur "Gërmia".*

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.